

Vendim nr. 9 datë 15.01.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 15.01.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 13 (I) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ILIR MUZHAQI

OBJEKTI: Cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Ilir Muzhaqi në datën 09.10.2023 është arrestuar në flagrancë pas kallëzimeve të disa shtetasve për veprën penale “Mastrimi”. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë i është drejtuar asaj gjykate me kërkesë për vleftësimin e arrestit në flagrancë të kërkuesit dhe caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*).

2. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 2357 Akti, datë 12.10.2023, ka vendosur vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë të personit nën hetim/kërkuesit dhe caktimin si masë sigurimi personale shtrënguese “Arresti në burg”. Vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 1937, datë 24.10.2023 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

3. Në vijim, kërkuesi në datën 16.01.2024 i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë me kërkesë për shuarjen e masës së sigurimit “Arresti në burg” të dhënë me vendimin nr. 2357 Akti, datë 12.10.2023 të gjykatës së shkallës së parë. Kërkuesi ka kërkuar zbatimin e normave procedurale për marrjen në pyetje të personit të arrestuar sipas nenit 248 të KPP-së, pasi sipas tij, në kushtet kur nuk është zbatuar kjo dispozitë, pra marrja në pyetje brenda 48 orëve, duhet të zbatohet neni 261 i KPP-së, që parashikon shuarjen e masës së sigurimit.

4. Gjykata e shkallës së parë, me vendimin nr.136 Akti, datë 29.01.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për shuarjen e masës së sigurimit “Arresti në burg”. Ndaj këtij vendimi kërkuesi ka ushtruar ankim dhe gjykata e apelit, me vendimin nr. 557/30-2024-1626, datë 05.03.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 136 Akti, datë 29.01.2024 të gjykatës së shkallës së parë. Ndaj vendimit nuk rezulton të jetë ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

5. Kërkuesi në datën 28.08.2024 (*data e shërbimit postar*) i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë, sipas objektit, e cila, pas plotësimit të dokumenteve të kërkuara, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar përfundimisht në datën 14.10.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është *cenuar e drejta e aksesit*, pasi gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim me nenet 246, 248 dhe 261 të KPP-së. Ai i është drejtuar disa herë gjykatës së shkallës së parë për zbatimin e normave procedurale, por nuk ka marrë përgjigje, nga kryetari i asaj gjykate. Gjykata e shkallës së parë, duke mos shqyrtuar kërkesën e për shuarjen e masës së sigurimit, ka ndërmarrë veprime që nuk mund të kryhen, si dhe është mohuar e drejta për t’iu drejtuar gjykatës, që lidhet me mbrojtjen e të drejtave të tjera në vazhdimësi të procesit gjyqësor.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

8. Në këtë këndvështrim, Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sepse është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

9. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “F”, i Kushtetutës, sipas të cilit individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngrenë në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Në thelb, ky rregull synon t’u japë organeve publike dhe, në veçanti, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit. Ana tjetër e rregullit të shterimit të mjeteve juridike përfshin detyrimin e vetë individit që të tregojë kujdesin dhe vëmendjen e duhur për të paraqitur kërkesa, kundërshtime ose ankime te organet publike dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për rrethanat që mbështesin pretendimet për cenimin e të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës duke pretenduar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka shqyrtuar kërkesën e tij për shuarjen e masës së sigurimit, duke cenuar të drejtën për akses. Nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllim të shqyrtimit të ankimit kushtetues individual, rezulton se gjykata e shkallës së parë, me vendimin nr. 136 Akti, datë 29.01.2024, ka vendosur rrëzimin e

kërkesës për shuarjen e masës së sigurimit. Ndaj vendimit kërkuesi ka paraqitur ankim dhe gjykata e apelit, me vendimin nr. 557/30-2024-1626, datë 05.03.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke u shprehur në dispozitiv se ndaj tij mund të bëhet rekurs brenda 45 ditëve nga komunikimi. Në datën 25.04.2024, sipas dëftesës së komunikimit, rezulton se vendimi i është komunikuar kërkuesit, por nuk rezulton që ai të ketë paraqitur rekurs. Në vijim, Gjykatës së Lartë i është kërkuar informacion për çështjen konkrete. Në datën 26.11.2024 ajo gjykatë ka informuar se pranë saj nuk rezulton të jetë regjistruar në emër të kërkuesit çështje penale me objekt shuarjen e masës së sigurimit “Arresti në burg”.

11. Për sa më lart, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës së aksesit në lidhje me shqyrtimin e kërkesës për shuarjen e masës së sigurimit, e cila jo vetëm është shqyrtuar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, por ai ka në dispozicion mjete juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tij, sikur është rekursi në Gjykatën e Lartë, të cilin, në kuptim të kriterit të shterimit, duhet ta përdorë ose, në të kundërt, duhet të argumentojë e të provojë se përdorimi nuk do të ishte efektiv në rastin e tij, çka nuk ka ndodhur në rastin konkret.

12. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, ndaj në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre. Për rrjedhojë, ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “d” të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.